



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përgjigje të kërkesës ku kërkoni informacion lidhur me trajtimin e rasteve të diskriminimit / abuzimit / neglizhencës ndaj Moshës së Tretë për periudhën 2020-2022 vihet në dispozicion informacioni i kërkuar nga KMD.

“Moshë” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Gjatë punës së tij, Komisioneri ka trajtuar raste ankesash dhe ka iniciuar hetime ex-officio lidhur me rastet e diskriminimit ndaj moshës së tretë, të cilat kanë të bëjnë më së shumti me aspektin e ofrimit të shërbimit kryesisht në sistemin sigurimeve shoqërore, sa i përket përlllogaritjes së masës së pensionit apo përfitimit nga shtesa e pensionit suplementar. Gjithashtu, një ndër problematikat e ngritura gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga ky grup personash, lidhet dhe me refuzimin e tyre në Shtëpitë e të Moshuarve.

- Gjatë periudhës 2020-2022, Komisioneri ka trajtuar **14 çështje** ku të moshuarit kanë qenë subjekt i ankesave në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Komisioneri në përfundim të trajtimit të tyre, kryesisht ka dalë me vendime pushimi apo mospranimi, për shkak se çështjet kanë qenë jashtë kompetencave dhe fushës së veprimit të tij dhe konkretisht:
  - 8 Vendime për mospranimin e ankesave, për shkak se çështjet kanë qenë jashtë kompetencave dhe fushës së veprimit të tij ose nuk kanë plotësuar kërkesat e LMD-së;
  - 2 Vendime mosdiskriminimi, për shkak se nuk është arritur të konstatohet situatë diskriminuese;
  - 2 Vendime pushimi, për shkak se gjatë shqyrtimit të çështjeve është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishin nisur procedurat hetimore;
  - 1 Vendim pushimi, pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
  - 1 rekomandim për marrjen e veprimeve pozitive, në pikat kufitare, gjatë periudhës së pandemisë, duke i dhënë përparësi: të moshuarve, fëmijëve, personave me gjendje të rënduar shëndetësore, personave me aftësi të kufizuara dhe grave shtatzëna.

- Objekti i çështjeve të trajtuara nga Komisioneri për këtë periudhë raportimi ka qenë:
  - shtesa e pensionit suplementar, në masën 50%;
  - mosmarrja e shërbimeve për shkak të moshës, si p.sh. lëshimi i dokumentave të pronësisë nga ana e ASHK-së;
  - faljen e detyrimeve ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë;
  - refuzimi për sistemimin në Shtëpitë e të Moshuarve;
  - përlllogaritja e gabuar e masës së pensionit nga ana e strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;